Kronikë

Tiranë, hodhën fishekzjarre në mesnatë, kapen 3 persona

Mesnatën e djeshme janë konstatuar 3 raste të hedhjes së fishekzjarrëve nga individë duke prishur qetësinë publike dhe është bërë e mundur kapja e 3 personave.

Fishekzjarre

Redaksia
15 Prill, 12:48 | **Përditesimi: 15 Prill, 13:01**

Share

TIRANË - Fishekzjarret në mesnatë janë kthyer në një problem për banorët e kryeqytetit duke prishur qetësinë publike. Policia ka filluar të marrë masa, duke monitoruar situatën në terren për kësi rastesh.

Mesnatën e djeshme janë konstatuar 3 raste të hedhjes së fishekzjarrëve nga individë duke prishur qetësinë publike dhe është bërë e mundur kapja e 3 personave.

- Në rrugën "Arkitek Sinani", është konstatuar shtetasi M. Xh.;
- Në rrugën "Omer Nishani", është konstatuar shtetasi B. K.;
- Në rrugën "Spiro Cipi" është konstatuar shtetasi A. V.;, thuhet në njoftimin e policisë.

Gjithashtu policia ka sekuestruar lëndët piroteknike të hedhura si provë materiale dhe rastet e mësipërme i janë kaluar Prokurorisë për veprat penale 'Prishja e qetësisë publike' dhe 'Shkelja e rregullave mbi përdorimin e lëndëve plasëse'.

LEXO EDHE:
Ekspozitë unike, vijnë në Tiranë 5 trofetë prestigjoz të Manchester Cityt! Bashkëpunim me Dyrrah City

'Ju sjellim në vëmendje se në zbatim të ligjit 73, viti 2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve pirotekenik", Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë është e vendosur për goditjen e kësaj paligjshmërie dhe bën thirrje për të gjitha subjektet që tregtojnë artikuj piroteknikë, si dhe qytetarëve, që të respektojnë kërkesat e neneve 15, 16 dhe 26 të ligjit "Për magazinimin, shitjen dhe përdorimin e artikujve piroteknikë si dhe masat e sigurisë".

Në të gjitha rastet kur shërbimet e policisë do të konstatojnë përdorimin e lëndëve piroteknike në kundështim me këtë ligj, për subjektet dhe personat përgjegjës, përveç masave administrative të cilat do të shoqërohen me gjobat përkatëse dhe me sekuestrime të lëndëve piroteknike, do të procedohen penalisht edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 282 dhe 274 të Kodit Penal', thuhet më tej në njoftimin e policisë.

DVP Tiranë gjithashtu është e vendosur për goditjen e paligjshmërisë së hedhjes në treg të lëndëve piroteknike, për të cilën shprehet se do të përballen me ligjin.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: fishekzjarre Tiranë

Komento

Komente

Kasem Gahinji: 15/04/2024 14:40

Krim shume i rende,Jane shqetesuar njerezit ne mesnate nga fishekzaret.As qe mund te krahasohet me lojen shaka' te Ca peotestuesve me" Shishe molotov' mbi kokat e policeve.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Basha akuzon se ka aleancë PS-Rithemelimi kundër SPAK, e besoni?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kevin, lulet dhe shokët e tij në Tiranë

Alba Malltezi

14 Prill, 18:50

Itali/ Veliaj takon homologët e Veronës dhe Viçencës: Zgjerojmë bashkëpunimin për 'Eco Tiranën', së shpejti shërbime të reja në kryeqytet

14 Prill, 15:08

Policia Rrugore e Tiranës: Javën që lamë pas 17 shoferë u arrestuan, mbi 12 mijë gjoba dhe 30 automjete të bllokuara

14 Prill, 11:38



Dy turistë çekë humbin në Malin e Dajtit, gjenden pas disa orësh

14 Prill, 10:43

Tiranë, 54 vjeçarja humb jetën në punë, e zunë poshtë dy palete me pije alkoolike (EMRI)

14 Prill, 08:37

Vendos Kristal Abazaj në limite, Tirana mposht 1-0 Kukësin dhe futet në 'Final 4'! Tifozët shajnë bardheblutë

13 Prill, 17:06

'Shokët nuk më thonë që jam i varfër!' Kevini, 11-vjeçari me 10-ta që punon të ndihmojë prindërit

Xhoana Çallaku

13 Prill, 15:51

Mbjellje pemësh te ish-Tregu Elektrik, Veliaj: Njerëzit janë të ndarë në ata që punojnë dhe ata që komentojnë punët! Ata që nuk bëjnë punë, historia i harron

13 Prill, 15:35

Basketboll/ Akti i parë flet për Partizanin, vajzat e kuqe fitojnë derbin në shtëpinë e Tiranës

13 Prill, 13:15

Veliaj inspekton në Kombinat: Në 2025 mbyllim rindërtimin! E zhbllokuam nga gjyqet e Monës dhe Likes, kanë 0 shans të rrëzojnë bashkinë

13 Prill, 13:01

Tentuan të korruptojnë policinë rrugore, 2 të arrestuar në Tiranë! Një ishte me masë arrest shtëpie

13 Prill, 10:25

FSHF KOMISIONI I DISIPLINËS

Disiplina 30 vendime në një ditë, dënohet 40 përqind e Superligës! Dhunë dhe kërcënime te moshat

13 Prill, 09:56

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje